

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI INSTITUCINAL ZGJEDHOR STUDENTOR

Nr. 75 / Prot

Datë, 5.2.2025

VENDIM

Nr. 4, datë 5.2.2025


PËR

FILLIMIN E PROCESIT TË VETËKANDIDIMIT TË ANËTARËVE PËR KËSHILLIN
STUDENTOR NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË"
DHE KËSHILLAT STUDENTORË NË FAKULTETE

Në zbatim të nenit 99 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 74 të Statutit të UV-së, nenit 4, nenit 14 të Rregullores për zgjedhjen e këshillave studentorë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurave dhe njoftimin për vetëkandidim për anëtarë të Këshillit Studentor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.
2. Dokumentacioni për kandidim nga kandidatët dorëzohet në KIZS dhe përmban:
 - a) Kërkesën për aplikim e cila përfshin: emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim për anëtarë të KSF;
 - b) fotokopjen e dokumentit të identifikimit;
 - c) vërtetimin që provon se është student pranë fakultetit përkatës;
3. Pas verifikimit të dokumentacionit, KIZS-ja, jo më vonë se 24 (njëzetekatër) orë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim, miraton listat e kandidatëve
4. Listat përfundimtare përcillen në komisionet zgjedhore studentore të fakulteteve dhe shpallen publikisht në mjediset e fakultetit përkatës dhe në faqen zyrtare në internet.
5. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve nga data 04.02.2025 deri në datë 14.02.2025, brenda orarit zyrtar, 8:00-16:00.
6. Vetëkandidimet dorëzohen pranë sektorit të protokoll arkivës në Rektoratin e UV-së.
7. Vendimi publikohet në faqen web www.univlora.edu.al.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI INSTITUCINAL ZGJEDHOR STUDENTOR

Kryetar i Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor

Fatjon Tushe

Anëtarët

Fabjon Aliaj

Megi Çeku

Zaro Hasani

Ornea Ramohitaj